



**REPUBLIKA E MAQEDONISË VERIORE**  
**AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUALE**  
**Nr. 03-189**  
**22.05.2023**  
**Shkup**

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168 /18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.42/20 dhe 77/21), dhe në lidhje me nenin 15 paragrafi (1) dhe paragrafi (6) dhe neni 29 nga Ligji për Media ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë " nr. 184/13 dhe 13/14 ), pika 7 dhe 14 e Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masave (Tekst i pastruar) ark. nr. 01-4139/1 të datës 7.11 .2022, Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative, ark.nr.03/1894/1 datë 24.4.2023 dhe Konkluzionin ark.nr..02-2106/2 datë 19.5.2023, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në seancën e 15-të mbajtur më 18.5.2023 miratoi si vijon:

**Aktvendim**  
**për ndërmarrje të masës – vërejtje publike**

1. PUBLIKISHT PARALAJMËROHET Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (SHTR) Televizioni IRIS SHPK Shtip, për shkelje të nenit 15 paragrafi (1) të Ligjit për Media (LM), në atë mënyrë që SHTR Televizioni IRIS SHPK Shtip, nuk e ka përmbushur detyrimin nga neni 15 paragrafi (1) nga LM, gjegjësisht drejtuar Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Agjencia) nuk dorëzoi të dhëna për strukturën e pronësisë, redaktorin/redaktorët përgjegjës, burimet e financimit në vitin 2022, të ardhurat dhe shpenzimet totale të realizuara nga ofrimi i aktivitetit në vitin 2022 dhe për shikueshmërinë mesatare në vitin 2022.

Shkelja nga paragrafi (1) i kësaj pike, është specifikuar dhe në Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative, ark.nr.03-1894/1 datë 24.4.2023, si pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojcë nr.1.

2. URDHËROHET SHTR televizioni IRIS SHPK Shtip, në afat prej 45 (dyzet e pesë) ditësh nga dita e pranimit të këtij Aktvendimi, ta harmonizojë punën e tij me dispozitat e LM.

3. Pas skadimit të afatit përcaktuar në pikën 2 të këtij aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i përcaktuar në pikën 1 të këtij Aktvendimi, ka vepruar sipas Aktvendimit.

4. Ky Aktvendim është përfundimtar dhe si ditë e miratimit konsiderohet dita e çertifikimit në Arkivin e Agjencisë për Shërbime Mediale Audio dhe Audiovizuale.

**A r s y e t i m**

Agjencia në bazë të nenit 29 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LSHMAAV) dhe neni 29 të LM, Agjencia është kompetente për të kryer mbikëqyrjen administrative të veprimtarisë së botuesve të mediave nga aspekti i pajtueshmërisë së punës së tyre me detyrimet e neneve. 6, 8, 14 dhe 15 të LM.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë ndërmerr masë - aktvendim për vërejtje publike në pajtim me këtë ligj, në rastet kur ka shkelje të dispozitave të LSHMAAV dhe të akteve nënligjore miratuar në bazë të të njëjtit ligj, si dhe të kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara me lejen dhe aktet e tjera të Agjencisë.

Në përputhje me nenin 29 paragrafi (2) të LM, masat që Agjencia si organ kompetent rregullativ mund t'i ndërmarrë, të cilat janë të përcaktuara në LSHMAAV, zbatohen gjithashtu dhe në rast të shkeljes së dispozitave të LM.

Sipas nenit 15 paragrafi (1) të LM, transmetuesit janë të obliguar që deri më 31 mars të këtij viti në formular të veçantë të përcaktuar nga organi kompetent rregullator të dorëzojnë të dhëna për: strukturën e pronësisë, përkatësisht të dhënat për emrin dhe selinë e personit juridik ose emrin dhe vendbanimin e personave fizikë që zotërojnë aksione ose aksione tek botuesi i medias, me të dhëna për përqindjen e aksioneve ose të aksioneve që kanë fituar dhe datën e blerjes, të dhëna për redaktorin/redaktorët përgjegjës, të dhëna për burimet e financimit të transmetuesit në vitin paraprak (reklama, sponsorizimi, shitja e përmbajtjes, shërbimet e ofruara palëve të treta etj.), të dhënat për totalin e të ardhurave dhe shpenzimeve të transmetuesit në vitin paraprak nga ofrimi i veprimtarisë (aktivitetit) dhe të dhënat për shikueshmërinë ose dëgjueshmërinë mesatare. të transmetuesit në vitin paraprak.

Në kuadër të kompetencave ligjore, Agjencia nëpërmjet Sektorit për planifikim strategjik dhe mbrojtje të së drejtës së autorit, më 24 prill 2023, ka kryer mbikëqyrje të rregullt administrative ndaj SHTR televizionin IRIS SHPK Shtip, duke konstatuar shkelje të nenit 15 paragrafi (1) të LM.

Nga mbikëqyrja e rregullt është konstatuar se Televizioni SHTR IRIS SHPK Shtip, drejtuar Agjencisë nuk ka dorëzuar të dhëna për strukturën e pronësisë, redaktorin/redaktorët përgjegjës, burimet e financimit në vitin 2022, totalin e të hyrave dhe shpenzimeve nga ofrimi i aktivitetit në vitin 2022 dhe rreth shikueshmërisë mesatare në vitin 2022.

Shkelja nga pika 1 i këtij Aktvendimi është përcaktuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative, ark.nr.03-1894/1 datë 24.4.2023, i cili është pjesë përbërëse i këtij Aktvendimi si Shtojcë nr.1 .

Sipas neni 23 paragrafi (3) të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë drejtuar Televizionit SHTR IRIS SHPK Shtip , më 25.4.2023, ka dërguar Shkresë ark.nr. 03-1894/2 datë 25.4.2023. ku i dorëzoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative, ark.nr.03-1894/1 datë 24.4.2023, me qëllim që në afat prej prej 7 ( shtatë ) ditë pune nga dita e pranimit të shkresës, drejtuar Keshillit të Agjencisë të dorëzon deklaratë me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave nga LM. Shkresa u pranua në mënyrë të rregullt nga ana e transmetuesit më 27.4.2023. Në afatin e përcaktuar, televizioni SHTR IRIS SHPK Shtip, nuk u deklarua për shkeljen e kryer nga Ligji. Këshilli i Agjencisë në seancën e mbajtur më 18.5.2023, pasi shqyrtoi lëndën Raport me shkrim dhe konkludoi se ndaj SHTR televizioni IRIS SHPK Shtip t'i shqipton masë-vërejtje publike.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 15 paragrafi (1) dhe paragrafi (6) dhe neni 29 të LM, Rregulloren për mënyrën e publikimit të të dhënave për punën e transmetuesve, pika 7 dhe 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas Aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Tekst i pastruar), Raportin me shkrim mbi mbikëqyrjen e kryer administrative, ark.nr.03-189 4/1 datë 24.4.2023 dhe Konkluzionin ark. nr.02-2106/2, datë 19.5.2023, për shkak të mosrespektimit të dispozitave nga LM, të përcaktuara në pikën 1 të këtij Aktvendimi, Këshilli i Agjencisë në seancën e 15-të, mbajtur më 18.5 2023, miratoi Aktvendim me të cilin publikisht paralajmërohet SHTR televizioni IRIS SHPK Shtip, dhe udhëzohet që në afat prej 45 (dyzet e pesë) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi që të harmonizojë punën e tij me dispozitat e LM. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij aktvendimi, Agjencia do të kryejë mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i përcaktuar në pikën 1 të këtij aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit.

Në bazë të nenit 24 të LSHMAAV, ky Aktvendim është përfundimtar dhe kundër tij botuesi i medias (transmetuesi) ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ praqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit..

Bazuar në sa më sipër u mor aktvendim si në dispozitiv.

**Agjencia për Shërbime Mediatike  
Audio dhe Audiovizuale,  
Kryetari i Këshillit  
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

**Këshillë juridike:** Kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ praqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

**Shtojcë (1):**

- 1) Raport me shkrim mbi mbikëqyrjen administrative, ark.nr.03- 1894 /1 datë 24.04.2023.